



KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË

SKUPŠTINA OPŠTINE - SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA



PROCESVERBAL 1/2025

I mbajtur me rastin e mbledhjes së I (parë) për vitin 2025 të Kuvendit të Komunës së Suharekës

Vendi: Suharekë
Zyra: Salla e Kuvendit të Komunës
Data: 30.01.2025
Ora: 10:00

Prezentë në takim:

Z. Shefket Kolgeci

Z. Selman Kolgeci

Z. Flamur Bytyqi

Z. Urim Suka

Z. Kushtrim Kuçi

Znj. Elmaze Bytyqi

Znj. Bulëza Kuçi

Znj. Doruntina Zenelaj

Z. Alban Berisha

Z. Bexhet Kuçi

Z. Reshat Selimaj

Z. Lirim Qatani

Z. Aziz Bytyqi

Znj. Sanie Kuçi-

Rexhepaj

Znj. Fidaije Kukaj

Znj. Afërdita Morina

Z. Vullnet Luzhnica

Z. Xhevshet Gashi

Z. Edon Sadikaj

Znj. Saranda

Bajraktari

Znj. Mimoza Bajraktari

Znj. Festë Kabashi

Z. Dardan Berisha

Z. Bajram Basha

Znj. Mevlude Kabashi

Znj. Sheqerije Zyrapi

Znj. Laureta Tafaj

Z. Liridon Fandaj

Z. Qëndrim Elshani

Z. Herolind Limaj

Znj. Jehona Lumi

Rrafshi

Të pranishëm të tjerë

Kryetari Komunës

Media dhe qytetarë

OSCE, LMT, KDI

Znj. Habibe Bytyqi

Z. Xheladin Sadikaj

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi,i cili propozoi këtë:

REND DITE

1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

2.Shqyrtimi i projekt-vendimit për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-016-6358 të datës 28.01.2022;

3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;

4.Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;

5.Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;

6.Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit me numër të protokollit 01-Nr-052-2910 të datës 14.01.2025 dhe Marrëveshjes;

7.Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit financiar të ekzekutimit dhe administrimit të buxhetit të Komunës së Suharekës;

8.Shqyrtimi i projekt-vendimit për përmbushjen dhe tejkalimin e planit buxhetor të të hyrave vetanake për vitin fiskal 2024,të barten për shoenzim në vitin fiskal 2025;

9.Diskutim për shfrytëzimin e hapësirave publike në qytetin e Suharekës për vendosjen e panove reklamuese;

10.Pyetje dhe përgjigje;

Selman Kolgeci - kam një kërkesë që e kanë dërgu në komunë për një shtëpi që është djeg në Gjinoc në emër të Mustaf Zenelaj dhe nuk është fut si pikë këtu jasht rendit të ditës.

Kryetari - është protokolu dhe vjen seancën tjetër.

Unanimisht Miratohet rendi i ditës.

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1.

Unanimisht Miratohet pika 1

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-016-6358,të datës 28.01.2022;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe fjalën ia jep Kryetarit për të propozuar anëtarin e komisionit.

Kryetari - propozoi Shega Bjaraktari.

Urim Suka - e kuptojmë situatën që ky vendim pas daljes në pension të zyrtarit Agim Rraqi duhet të plotësohet me një anëtar të ri dhe ne si LDK do ti japim mbështetje.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 2.

25 për,3 apstenime,Miratohet pika 2

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi - elaboron pikën dhe kërkon emrat e anëtarëve të komisionit nga subjektet politike.

Aziz Bytyqi - propozojmë Saranda Bajraktari.

Elmaze Bytyqi - propozojmë Kushtrim Kuçi.

Dardan Berisha - ne nuk kemi propozim për këtë komision.

Laureta Tafaj - ne nuk kemi propozim.

Jehona Rrafshi Lumi - nga subjekti NISMA nuk ka propozim.

Herolind Limaj - nuk kemi propozim.

Kryetari - Ardian Kotorri,Armend Krasniqi,Suzana Gashi.

Kryesuesi - e hedh në votim komisionin në këtë përbërje: Saranda Bajraktari, Kushtrim Kuçi, Ardian Kotorri, Armend Krasniqi dhe Suzana Gashi.

27 për,Miratohet pika 3

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Kryetari - e dini që deri tash nuk ka pas asnjë lëvizje te Agrozona dhe vitin e kaluar kemi shkëput 10 kontrata pasi nuk kanë punu asgjë. Këta që kanë konkuru shpresoj që punojnë.

Urim Suka - edhe ne jemi të interesuar që ajo zonë të funksionalizohet sa më parë dhe pse jo të jepet në shfrytëzim.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 4 që parcelat të jepen në shfrytëzim për 99 vite.

25 për,3 apstenime,Miratohet pika 4

Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi - elaboron pikën dhe hap debatin.

Kryetari - unë them që të jepet në shfrytëzim për 5 vite.

Urim Suka - ne jemi të vetëdijshëm që komuna e Suharekës duhet me pas një hapësirë të tillë ku qytetarët mund ti hudhin mbeturinat e ngurta por jemi të shqetësuar për mënyrën se si po provohet ky vendim me na ardhë këtu dhe për vonesën që si ekzekutiv e keni bërë deri në trajtimin e lëndës. Ju vet e thatë që nga korriku i 2024-tës i ka skadu afati i kontratës dhe prej atëherë deri tash Komuna nuk e ka një hapësirë të ligjshme për me i hudh këto mbeturina dhe kjo është pasojë e përgjegjësisë që ju nuk e keni krye këtë çështje me kohë. Ne fillimisht kemi pas shumë ankesa të qytetarëve për atë hapësirë atëherë dhe kemi pas diskutime me Drejtorin Enver Shabani për këtë çështje dhe me sa e di unë përgjegjja e drejtorit ka qenë që brenda një viti do të mbyllet kjo hapësirë, do të rrafshohet dhe do të kthehet në hapësirë gjelbëruese dhe do ta gjejmë një hapësirë tjetër për mbeturina. Mirëpo tash përveq se jeni vonu, po provojmë prap me qu në të njëjtin vend. Ne nuk e mbështesim si projekt të tillë dhe po provojmë me kërku që të mos kaloj ky vendim si i tillë dhe në një periudhë shumë të shkurtë ju si ekzekutiv ta gjeni një hapësirë tjetër që i përgjigjet nevojave për me funksionalizu një zonë të tillë dhe e mbështesim një vendim tjetër, me një hapësirë tjetër dhe jo në hapësirën ku ju e keni propozu.

Armend Krasniqi - përshëndet të pranishmit. Mendoj që këtë debat e kemi konsumu edhe herën e kaluar kur e kemi sjell në Asamble për shkak të një gabimi që e ka bë drejtoria për mos me publiku në listen e veqantë të pronave për dhënie në shfrytëzim. E kemi ripërsërit si vendim dhe është shumë e rëndësishme për komunën e Suharekës. Nëse sot nuk mbështetet ky vendim, ne krijojmë skandal me deponi ilegale të cilat mund të devijojnë. Kërkoj mbështetjen tuaj në iniciativën tonë për shkak se faji i mos planifikimit të ndonjë vendi për hüdhen e mbeturinave është faji i përgjithshëm sepse nuk e kemi shiku mirë HZK-në kur e kemi mirartu dhe nuk kemi kriju një alternativë për me përcaktu një vend tjetër. Po ashtu kemi problemin e njejtë me rastin e kafshëve të cilat po ngordhin dhe nuk kemi si Komunë një vend tjetër të planifikuar me HZK por për problemin që po e diskutojmë është mirë ta mbështesim.

Kryesuesi - siç e cek drejtori arsyeja se pse nuk ka kalu ligjshmëria e vendimit vitin e kaluar është se nuk ka qenë në listen e pronave për dhënie në shfrytëzim dhe tash kjo figuron në listen e pronave për dhënie në shfrytëzim.

Urim Suka - drejtori tha që krijohet skandal nëse nuk miratohet por skandali veq ka ndodh sepse jemi 8 muaj me vonesë. Kur është mirartu HZK-ja është dasht me u integru këto çështje dhe me planifiku se ku kemi me pas një hapësirë më të përshtatshme për mbeturina dhe skandali tjetër pse jemi vonu dhe që është përgjegjësi e drejtorisë dhe e ekzekutivit tuaj është për faktin që nuk e ka ditë që kjo kontratë i del në korrik dhe nuk e ka parapa në planifikimin e zonave që jepen në shfrytëzim dhe tash thotë që bëni skandal nëse ju nuk e votoni. Ne nuk jemi kundër që me pas një deponi por jemi kundër hapësirës se ku po planifikohet.

Armend Krasniqi - disa organizata ndërkombëtare kanë konstatu që Komuna e Suharekës është një ndër komunat më të pastërta në Republikën e Kosovës dhe njëra ndër arsyet se komuna e Suharekës ka dal si më e pastër, ka qenë edhe shkak i një përcaktimi të kësaj zone ku kemi konstatu që duhet me u hüd ato mbeturina në atë vend. Gabime të vogla teknike ka pas mirëpo janë eliminu dhe po krijojmë një alternativ për 3 apo 5 vitet e ardhshme dhe duhet të mbështetet.

Dardan Berisha - ne kemi pas kohë si asambleista dhe ndoshta nuk e kemi analizu parcelën si duhet por në këto çaste jemi ndërmjet dy proceseve, ose të krijojmë një katrahurë më të madhe ose ti japim dritën e gjelbër këtij procesi që unë mendoj që është shumë e rëndësishme për qytetarët, nëse jemi të thirrur këtu për qytetarët. Ne e dimë që Suhareka nuk ka shumë hapësira për grumbullimin e deponisë por a është e mundshme me bë 3 vite që të kemi mundësi me bë ndryshime në atë hapësirë ose a vërtetohet prej drejtorisë që ka mundësi edhe 5 vite me hüd mbeturina aty?

Liridon Fandaj - përshëndet të pranishmit. Unë e kam diskutu edhe në KPF dhe kam pa që kjo deponi me destinimin si është dhënë, nuk është respektu. Sa i përket asaj që tha drejtori që qyteti është më i pastër, ajo deponi është për mbeturina të ngurta dhe jo për mbeturina të tjera por aty ka qenë një neglizhencë e inspeksionit që nuk e ka mbyll më herët dhe tani është edhe neglizhencë e ekzekutivit që prej datës kur i ka skadu kontrata nuk e ka marrë në menaxhim. Ne propozojmë që kjo deponi pasi edhe nuk i plotëson kushtet dhe deri sa të gjendet një vend tjetër, të menaxhohet nga Eko Theranda.

Kryesuesi - kërkesa e Kryetarit ishte që të jepet për 5 vite dhe kërkesa e Dardanit ishte për 3 vite ose nëse është mundësia edhe për 5 vite. E hedh në votim propozimin e parë që të jepet në shfrytëzim 5 vite.

15 për, 13 kundër, 1 apstenim, Miratohet pika 5

Pika 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit me numër të protokollit 01-Nr-052-2910 të datës 14.01.2025 dhe Marrëveshjes;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Alban Berisha - I përgëzoj komisionin për punën që e kanë bërë kaq qetë. Dy mandate po kalojnë dhe për një rast të njejtë nuk kanë arrit me bë marrëveshje. Dua ta di se çfarë kritere janë përdor këtu dhe si është kry kaq shpejt kjo?

Kryesuesi - këtu nuk kanë pas telashe sepse këtu është një investitor dhe aty janë dy investitor. Drejtorin nuk e kemi për të dhënë sqarime pasi është kryesues i komisionit. Pjesën për ku po aludon, edhe mua më vjen keq.

Bulëza Kuçi - përshëndet të pranishmit. Unë për deri sa jam anëtaree komisionit për te çështja e Agit, dua të ju njoftoj që ai komision nuk është duke funksionu fare, jo për shkak të mos prezencës tonë por për shkak se nuk janë duke na ftu në komision. Besoj që në takimin e radhës duhet të marrim një vendim që ose me vazhdu pro ose mu tërhek.

Urim Suka - këto vendime kur të kryhen përmes komisioneve të caktuara duhet me kalu edhe në Kuvendin e Komunës mirëpo kjo lëndë deri sa ka ardhë deri këtu e ka një histori të caktuar dhe me gjithë këtë histori ne atëherë e kemi dhënë fjalën tonë dhe e dimë të gjithë se ka kalu nëpër disa procedura që nuk kanë qenë të mirëfillta por kanë qenë të paramenduara më herët dhe për shkak të asaj ne edhe sot e vazhdojmë votën kundër edhe për këtë projekt-vendim.

Liridon Fandaj - ne e kemi diskutu në KPF dhe kemi kërku një sqarim prej kryesueses së komisionit për përllogaritjen e kësaj përqindjes 27% sepse nëse ka qenë brenda bllokut ose objektit 27% atëherë është dasht të llogaritet edhe pjesa nën përdhes që është podrum dhe garazh për me u shëndrru në banesa dhe lokale ashtu si ka qenë marrëveshja. Në raport e kemi të mangët këtë pjesën e përqindjes.

Kryesuesi - nuk është kryesuesja e komisionit dhe nuk di të jap përgjigje.

Liridon Fandaj - i bie që ne duhet me kalu një vendim edhe nëse nuk është në rregull.

Kryesuesi - faktikisht është raport dhe besoj që është në rregull. E hedh në votim pikën 6.

16 për, 12 kundër, Miratohet pika 6

Pika 7. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit financiar të ekzekutimit dhe administrimit të buxhetit të Komunës së Suharekës;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Urim Suka - ju po e përgëzoni për buxhetin por ne të gjithë e dimë se çka ka ndodh me buxhetin dhe se si është shpenzu buxheti dhe fatkeqësia është që edhe këtë vit sikur viteve tjera ekzekutimi i buxhetit ka shku këtë vit ndoshta edhe më keq se viteve tjera për shkak se ka pas shumë vonesa në implementimin e shumë projekteve dhe qytetarët janë malltretu si te rruga "Sënderbeu", si te sheshi i qytetit por edhe për secilin projekt tjetër cilësia e punimeve len jashtëzakonisht shumë për tu dëshiruar. 98 % i shpenzimit të buxhetit për me kuptu më mirë qytetarët është mirë të sqarohet dhe të thuhet se një pjesë e madhe e këtyre mjeteve që janë shpenzu, janë dhe si rezultat i procedurave përmbarimore gjyqësore që ju e dini dhe që unë dua më saktësisht të na tregoj Drejtori i Financave se sa është dëmtu komuna me këto procedurat përmbarimore. Nga investimet kapitale sa para janë marrë dhe që kanë shku te procedurat përmbarimore? Te pjesa e projekteve, unë nuk e kam studiu mirë këtë raport por kërkoj dy sqarime. P.sh. te rrugët në Greiqec këtu figuron që janë pagu 50.000€ me një vend dhe 20.000€ me një vend por me sa unë e di rruga "Seferi" dhe rruga "Dy Martirët" unë nuk e di që këto rrugë janë përfundu. Këto dy rrugë që janë pagu dhe qenkan kryer, a janë kry në teren dhe nëse jo ku kanë shku këto pare? Pyetja tjetër ka të bëjë me rrugët në Suharekë: këtu po figuron që janë shpenzu 80.000€ për ndërtimin e rrugëve: "Agron Berisha, Xhavit Sylja, Çajupi, Zek Bajraktari"-segment, etj. Unë nuk i kam informacionet 100% por të paktën për disa rrugë unë e di që nuk është punu dhe dua ta di që këto 80.000€ ku kanë shku dhe a janë kry këto rrugë për çka po figuron këtu? Është mirë që të marrim përgjegjësi të paktën vitin tjetër dhe mos t'na përsëriten këto malltretimet e qytetarëve, me vonesa në projekte, me cilësi të dobët të punimeve dhe me anashkalim të vendimeve të Asamblesë sepse edhe në këtë raport që ju e keni sjell, këtu figurojnë plot rrugë për imnvestime por në fakt në teren ato nuk kanë ndodh dhe unë besoj në seancat e ardhshme do ti sjelli ato me fakte konkrete.

Labinot Halitjaha - komuna e Suharekës si buxhet për vitin 2024 e ka pas të miratuar 22.084.000€ ndërsa janë alokuar 25.425.000€ me të gjitha pjesët tjera, siq janë granti i performances dhe pjesa e tejkaluar e të hyrave vetanake. Të hyrat vetanake kanë qenë të planifikuara 2.252.000€ ndërsa janë mbledhur 2.954.000€ me gjoba dhe kamata. Të hyra vetanake janë më shumë se të planifikuara dhe janë 701.872€ të cilat do të barten në vitin 2025 për projektet të cilat veq i kemi në pikën tjetër. Si buxhet është ekzekutu në mënyrën më të mirë të mundshme. Kemi pas disa probleme me procedurat përmbarimore të

cilat i ceki Urimi dhe si vlerë totale e përmbaruesit të investimet kapitale që janë marrë është 1.646.743€ ndërsa si total është 4.107.657€.

Urim Suka - për rrugët që ngrita unë nuk mora përgjigje. Kur i ke 22.000.00 të planifikuara, si janë aloku 25.000.00, këtë nuk e kuptova dhe nëse mund të ma sqarosh.

Labinot Halitjaha - drejtori jep sqarime.

Liridon Fandaj - jemi të shpenzimet sipas njesive buxhetore dhe kodet ekonomike për periudhën janar-dhjetor 2024 dhe unë kërkoj një sqarim prej drejtorit të kodi 14310 -kompenzimi i përfaqësimit brenda vendit. Çka nënkupton kjo? A janë vetëm përfaqësimet brenda vendit apo janë edhe këto fotot që po i bëjnë në atë kompaninë që po iu qon një ftesë në Amerikë e po dalin foto, po i shpenzojnë ato mjete. Te zyra e Kryetarit i kemi 10.780€, te Drejtoria e Urbanizmit i kemi 5.602.70€, cilat janë këto shpenzime dhe për çka shkojnë këto përfaqësimet?

Labinot Halitjaha - secila drejtori duhet të përgjigjet për shpenzimin në drejtorinë e vet.

Liridon Fandaj - unë kërkoja sqarim se cilat janë shpenzimet që përfshin ky kod.

Kryesuesi - besoj janë puntoritë që i bëjnë nëpër Kosovë.

Liridon Fandaj - puntoritë dhe përfaqësimet ndryshojnë. Mund të shkojnë te drekat zyrtare por jo edhe drekat zyrtare dhe përfaqësimet brenda vendit.

Labinot Halitjaha - të gjitha këto shpenzime, të gjitha drejtoritë kanë punëtori dhe përfaqësimet, ndënjëherë me ftesa të ndryshme edhe jasht vendit ku shpeshherë në takime dhe punëtori. Komuna përfiton grante e donacione andaj këto shpenzime krijohen në këtë formë.

Liridon Fandaj - a janë në këtë kod buxhetor nëse unë e kërkoj me shkrim, a janë këto përfaqësimet aty apo ka diçka tjetër?

Labinot Halitjaha - bëje kërkesën me shkrim dhe do ti sqarojmë për secilën drejtori.

Selman Kolgeci - sa projekte kanë mbet pa u realizu prej listës së projekteve të cilat kanë qenë m'u realizu në vitin 2024 dhe sa janë realizu dhe nuk janë pagu paratë për projektet që kanë qenë në vitin 2024 edhe pse e keni shpenzu 98 % të buxhetit?

Labinot Halitjaha - kur të bëhet tërheqja e disa mjeteve në mënyrë jo të paramenduar, normalisht që ka ndikim në projekte. Ka projekte të cilat nuk janë realizu dhe disa projekte të cilat kanë ngel pa u përfundu. Si listë ne duhet ta sqarojmë me email për secilin projekt që nuk është realizu dhe i cili ka mbet pa përfundu. Përgjigjen ta kthej me email për të gjitha projektet nëse ke interes.

Selman Kolgeci - nuk keni vend për me u krekos këtu që e keni shpenzu buxhetin për 98%. Ndoshta Drejtoria i Shërbimeve Publike në seancën tjetër na sjell një raport të projekteve të cilat kanë qenë të miratuara dhe nuk janë realizu.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 7.

16 për, 12 kundër, Miratohet pika 7

Pika 8. Shqyrtimi i projekt-vendimit për përmbushjen dhe tejkalimin e planit buxhetor të të hyrave vetanake për vitin fiskal 2024, të barten për shpenzim në vitin fiskal 2025;

Kryesuesi - elaboron pikën dhe hap debatin.

Urim Suka - ne gjithmonë e dimë që komunën ka me përcjell bartja e mjeteve, sidomos të hyrat vetanake e këto që mblidhen muajt e fundit. Gjithmonë jemi kritiku ne se pse po i bartim dhe tash kjo nuk po ju pengon më juve, edhe kur janë 700.000, edhe kur janë 1 milion. 224.000€ ishin të parapane për rrugën "Skënderbeu" po në fakt rruga "Skënderbeu" ka përfundu. Pse këto po planifikohen kur rruga është përfundu apo ka obligime që kemi mbet borgji? Ne në parim është dasht me mbështet bartjen e mjeteve por ne sot do të apstenojmë.

Fadil Hoxha - ZKF-ja jep sqarime sa i përket bartjes së mjeteve. Sipas planifikimit buxhetor janë tejkalu të hyrat duke përfshi denimet e gjykatave të trafikut dhe të pyjeve. Bartja të projekti i rrugës "Skënderbeu" mund të them që me buxhet të viti 2024 kanë qenë 100.000€ të planifikuara dhe prej këtyre 100.000 € të planifikuara, 20.000€ i kanë marrë vendimet e gjykatave. 355.980€ i kemi bart vjet me vendim për këtë projekt dhe prej këtyre përmbaruesi i ka marrë. Me gjithë kërkesat tona të cilat i kemi dërgu dy herë për

me i heq prej projekteve që kemi llogarit që s'ka me u bë shpenzim,i kemi marrë 216.754 dhe këto dy herë na i ka marrë përmbaruesi.Prej 216.754,ne këtyre iu kemi mbet borgj dhe del që bartja është 227.057,kur ti shtojmë këto dy minuset dhe 224.000 që është llogarit që kemi me i bart me pëlqimin dhe votat tuaja,mua më del që në bazë të asaj ne i mbesim borgj operatorit ekonomikë edhe 12.752,60 dhe sa janë kry punët në teren unë nuk e di.

Shefket Kolgeci - sa mjete i janë marrë Komunës duke pagu përmbaruesin me ankesat e punëtorëve shëndetësor dhe atyre arsimor,shujtat etj?Nëse keni një raport tash ose na tregoni mbledhjen tjetër.

Fadil Hoxha - totali i fundit është 4.107.657.16€ ose prej 10-tëshit 2.494.000€,prej 21-shit 779.969€ dhe prej 22-shit 835.000€.

Urim Suka - ne e miratruam raportin e shpenzimit financiar mirëpo Fadili tha një fakt: unë u vonova sepse duke ardhë,më erdh një lëndë prej ministrisë ku 500€ u dasht m'i fut dikund.Paramendo,ne e kemi miratu dokumentin pa ato që tha Fadili dhe pyetja është: a ke me i ndryshu në zyre sikurse i ke ndryshu ato propozimet e Asamblesë e nuk i keni fut apo ke me sjell prap me miratru ? sepse ne tash kemi miratu tjera të dhëna dhe kur ti shton ato që sapo i ngrite,dalin tjera të dhëna. Te rruga "Skënderbeu",bartja po i parasheh 224.000€ dhe ti the që me të dhënat që ke ti,prap borgji nuk mbulohet.Sa është ai borgji? Hajde ta rregullojmë dhe ta shlyejmë borgjin.Ne po flasim me të dhëna të çuditshme ku dikush i ka ndryshe, dikush ndrysh e ne e miratojmë këtu e dikush shkon në zyre dhe e ndryshon aty.Këto janë shkelje ligjore.

Fadil Hoxha - ajo nuk është që ndikon në bartjen e të hyrave vetanake,është pjesë e grantit.Janë gabimet e tyre dhe nuk është te pjesa e 21-shit që na ndikon kjo bartje.ZKF tutje jep sqarime.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 8.

15 për,3 kundër,9 apstenime,Miratohet pika 8

Asambleisti i LVV-së Liridon Fandaj kërkon që të numërohen votat edhe një herë sepse thotë që nuk janë numëruar mirë.

Kryesuesi numëron votat dhe konstaton që: 14 vota për,3 kundër,9 apstenime,Miratohet pika 8

Pika 9. Diskutim për shfrytëzimin e hapësirave publike në qytetin e Suharekës për vendosjen e panove reklamuese;

Kryesuesi - kjo pikë ka qenë kërkesë e Liridon Fandaj.Hap debatin.

Qëndrim Elshani - sa i përket shfrytëzimit të hapësirave reklamuese në komunën e Suharekës,e kam marrë fjalën në vitin 2022 kur i ka mbaru kontrata operatorit ekonomikë dhe kam bë thirrje te Kryetari i Komunës dhe te ekzekutivi që duhet me hap komuna procedurat për me mujt m'i shfrytëzu qytetarët, bizneset,partitë politike,ato hapësira reklamuese dhe Kryetari i komunës pat thënë që në janar të 2023-tës kryhet kjo punë,mirëpo kjo punë nuk është nis dhe nuk është kry.Për shkak të mospërgjegjshmërisë të Kryetarit të komunës, të Drejtorisë së Inspeksionit dhe operatorit ekonomikë,kanë ra në grackë edhe kandidatët tjerë për deputet dhe e kanë shkel ligjin.Sa i përket kësaj çështje,duhet që Drejtoria e Inspeksionit bashkë me Kryetarin dhe bashkë me operatorin ekonomikë me dhënë përgjegjësi dhe me na tregu se kush e ka përgjegjësinë kryesore për mos zbatimin e rregullave.

Kushtrim Kuçi - neve si parti politike na kanë denu.Ne kundrejt kujt duhet me bo padi? ndaj Drejtorisë së Inspeksionit,ndaj Kuvendit Komunal apo ndaj operatorit ekonomikë?Si ka të drejtë një operator ekonomikë të cilit i ka skadu kontrata,me vendos reklama nëpër shtylla elektrike dhe askush mos me marrë masa!

Kryesuesi - nëse keni bë një marrëveshje me kompaninë apo dikënd,aty kërkon llogari.

Armend Krasniqi - është jo situatë e mirë sa i përket çështjes së reklamave.Kontrata me operatorin ekonomikë ka skaduar në vitin 2022.Unë disa herë jam konsultu që me inicu procedurën prej Drejtorisë së Pronës por ne konsultim me zyrtarin ligjor neve na është rekomanduar që kjo procedurë mos me shku tutje nga ana jonë për shkak se nuk kalon në MAPL.Në bazë të një rregullore të cilën e kemi miratu në

Asamble në komunale, këtë iniciativë duhet ta marrë Drejtoria e Urbanizmit ndërsa njoftimin për mos lehtësimin e asnjë posteri e ka pas edhe Drejtoria e Inspeksionit dhe Drejtoria e Financave. Sa i përket pyetjes se kush duhet me marrë përgjegjësinë, në momentin e lidhjes së kontratës është dashtë ta pyesni operatorin se në bazë të cilit vendim po e vendos posterin.

Kushtrim Kuçi - ka dy vite që i ka skadu kontrata dhe ne edhe brenda këtyre dy viteve kemi pa reklama të firmave. Dikush e ka pagu operatorin ekonomikë dhe operatori ekonomikë i ka marrë paratë dhe s'ka pagu tatim.

Urim Suka - ne e kemi marrë si parti një denim, i qëndrojmë atij denimi dhe e kryejmë obligimin që kemi. Ne kemi qenë të vetëdijshëm se si është situata dhe ne nuk kemi vendos fare si parti postera por kur u mbush qyteti me postera, ishte një garë e pabarabartë elektorale dhe në anën tjetër komuna nuk vepronte. Komuna nuk po vepron që 2 vjet për këtë çështje. Ne e dimë denimin që e kemi marrë dhe i qëndrojmë mirëpo dëmi që po i bëhet nuk është për atë javë por është që 2 vite dhe komuna është duke hesht për këtë punë dhe kjo është e papërgjegjshme dhe dikush duhet me marrë llogari për këtë çështje.

Alban Berisha - jam i zhgënjyer me përgjigjen e Drejtorit të Pronës. Nuk më pëlqej sepse kur të përgjigjesh kështu, nuk po ndihem edhe unë shumë i qetë si qytetar që diçk nuk është në rregull. Më herët kur skadojshin kontratat e këtyre që banuan në banesat publike, shumë shpejt i keni nejt gati me i kqyr ato kontrata a kanë skadu apo nuk kanë skadu edhe pse nuk kanë qenë biznese duke banu aty por kanë qenë disa familje të marginalizuese dhe kanë pas një arsye pse kanë qenë duke banu në banesa publike dhe shpesh në ato seanca ne kemi reagu që mos po ngutemi pak por ligji është ligj, vendimi është vendim dhe afati është afat dhe jemi pajtu në fund të gjithë. Por kundrejt një biznesi që gjeneron të ardhura, juve iu ka ik si afat. Drejtor, inspeksioni në këtë rast është ekzekutues i vendimeve që i përcillni ju dhe Drejtoria e Urbanizmit. E di edhe unë që kolega e ka diskutu në 2022-tën këtë çka është duke ndodh ku bizneset kanë pagu. Nuk kam asgjë personale me biznesin në fjalë. Ne kemi pas edhe shumë biznese që i ka skadu kontrata për shfrytëzim dhe me krenari ke thënë që i ke rregullu këto punë dhe nuk ka më në Suharekë me shfrytëzu dikush pa pagu dhe të kam përkrah. Drejtor nuk na dhe arsyen e saktë se pse që dy vite pa kontratë. Edhe prej Kryesuesit më erdh keq se çdo herë e ka nga një përgjigje në gjep dhe sot i ike edhe ti kësaj përgjigje.

Kryesuesi - kjo nuk është punë e imja.

Alban Berisha - herave të tjera e ke marrë përgjegjësi me u përgjigj. Pse te pikat e fundit nuk është Kryetari, nuk janë drejtorat përkatës? A po i dini pikat cilat duhet me ik? Mua më korrespondon që në pikat e caktuara po duhet me dal jashtë se s'ka përgjigje dhe mos të vje puna që seancat me u bë monotone.

Armend Krasniqi - në momentin e skadimit të kontratës, ne i kemi njoftuar drejtoritë kompetente dhe çdo kush duhet me marrë përgjegjësinë e vet. Vërtetë është situatë e keqe por nuk është përgjegjësi e imja. Drejtori tutje jep sqarime.

Urim Suka - për mua nuk është me rëndësi se cila drejtori e ka përgjegjësinë por si ekzekutiv po e shohim. Merrne përgjegjësinë sepse keni gabu. Që dy vite është gabim i madh çka keni bë.

Armend Krasniqi - kontratat e banesave të cilat janë bë në pushtetin e atëherëshëm, absolutisht ato kontrata nuk janë shiku. Me ardhjen në detyrë i kam marrë të gjitha kontratat dhe i kam shiku dhe lirim i banesave ka qenë në mënyrë të rregullt. Si po e diskutoni këtë kur ka 25 vite që një njeri rrin në banes dhe nuk i paguan asnjë cent komunës dhe thua është vendim i gabuar. Drejtori tutje jep sqarime.

Flamur Bytyçi - drejtori tha që s'kemi mujt me shty përpara si procedurë sepse e ka në MAPL-jë dhe tash po kërkon që në seancën e radhës me marr si iniciativë me shty përpara. Nëse MAPL-jë e ka blloku dhe ti po insiston me u zhvillu një procedurë e re, si po mendon që ka me u krye kjo? Nuk po e kuptoj.

Armend Krasniqi - drejtoria jonë nuk është kompetentë për me inicuar procedurën e mëtutjeshme për shkak se ne nuk kemi mujt me gjet për me dhënë pronë dhe këtu duhet me dhënë vetëm hapësirën publike. Në kuadër të hapësirës publike bën pjesë Urbanizmi dhe besoj Urbanizmi në seancën e radhës do ta përgadit si pikë të rendit të ditës apo duke u bazuar edhe me rregulloren e cila e qartëson shumë mirë.

Pika 10. Pyetje dhe përgjigje;

Shefket Kolgeci - u bënë gati 5 vite dhe shkolla në Vraniq nuk është gati. Dua të di nga qeveria komunale se a keni ndonjë informatë, sugjerime, takime me Ministrinë që kjo shkollë do të kryhet këtë vit kalendarik 2025 ose të paktën deri në shtatorin e ardhshëm.

Urim Suka - kam marrë një kërkesë nga banorët e fshatit Sopijë dhe kam shku i kam vizitu atje. Fjala është te rrugën "Naum Veqilharxhi" në Sopijë, ku kam pa probleme të shumta në atë rrugë. A ka komuna një kontratë për mirëmbajtjen e rrugëve lokale dhe kur pritet me u rregullu kjo rrugë?

Enver Shabani - komuna e Suharekës e ka një kontratë me një kompani për mirëmbajtjen dhe sanimin e rrugëve lokale në gjithë territorin e Suharekës por ne intervenojmë në atë rrugë kur vje një kërkesë me shkrim ose dikush nga ne e konstaton që rruga është vërtetë e deformuar kurse sa i përket sigurisë që the ti, për ndonjë mur mbrojtës ose rrethoja, nuk parashihet të bëhet aty sepse është rrugë lokale ku shpejtësia zhvillohet 10-20 km/h por natyrisht është mirë me ngrit sigurinë e qytetarëve por nganjëherë nuk na lejojnë mundësitë buxhetore.

Urim Suka - sipas informatave të qytetarëve, ata kanë bërë kërkesë zyrtare me shkrim te ju dhe është mirë me intervenu nëse kontrata ekziston sepse është rrezik.

Kushtrim Kuçi - kanë shqetësim banorët e rrugës "Skënderbeu". Inkasanti i ujës jellësit ka shku me bërë regjistrimin e njehsorëve të ujës jellësit por fatkeqësisht nuk ka mundur ta bëjë regjistrimin sepse të gjitha orët që kanë qenë të vendosura në rrugë janë mbulu me zhavorr dhe me kubëza. A ka mbikqyrës të Kuvendit komunal kjo? Shqetësimi tjetër te kjo rrugë është se gjithëçka është keq. Kushtrim Kuçi këto shqetësime i paraqet edhe me foto. Shqetësim tjetër është prej banorëve të fshatit Stravuqin të cilët kërkesën e kishin bërë kaheerë që gjerësia e rrugës është shumë e ngushtë. Shpresoj ta merrni parasysh kërkesën e tyre.

Enver Shabani - komuna e Suharekës e ka një mbikqyrës të kësaj kontrate. Rruga Skënderbeu nuk ka përfundu si e tillë dhe shtresa e dytë e asfaltit pritet të shtrohet pas përmirësimit të motit. Sa i përket uji, ne nuk e kemi këtë informatë. Sa i përket Stravuqinës, ajo do të bëhet kur të bëhet buxheti.

Takimi përfundoi: 11:40

Procesmbajtësja: Dafina Haziraj



Kryesuesi i Kuvendit

Mr. ed Bexhet Kuçi

